URDHËR
Nr. 90, datë 26.3.2018

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të nenit 14, pika 3, të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 22, pika 3 dhe neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor në Autoritetin e Mediave Audiovizive, Sekretarit të Përgjithshëm, znj. Vera Muço.
2. Delegimin e kompetencave për njoftimin dhe ndjekjen e realizimit të detyrimeve financiare ndaj ofruesve të shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv, Sekretarit të Përgjithshëm të AMA-s.
3. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit.
4. Ngarkohet me zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm.

Ky urdhër hyn në fuqi në datën 2.4.2018 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gentian Sala